LIGJ
Nr.9842, datë 10.12.2007

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS HOLANDEZE "ING BANK N.V." PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "REHABILITIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJIT NË VLORË""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Holandeze "ING Bank N.V.", për financimin e projektit "Rehabilitimi i infrastrukturës së ujit në Vlorë"" në shumën 12 447 524 (dymbëdhjetë milionë e katërqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e njëzet e katër) euro.

Neni 2

Kredia i nënhuazohet Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve, Vlorë, sipas kushteve: periudha e maturimit 12 vjet, përfshirë 3 vjet periudhë grace, pa pagesë principali dhe interesi. Interesi për periudhën grace do të kapitalizohet dhe do t'u shtohet detyrimeve të shlyerjes së principalit.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5564, datë 27.12.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

PROJEKTMARRËVESHJE FINANCIARE
SHËRBIMI I KREDISË SË EKSPORTIT NË SASINË PREJ 12 447 524 EUROSH NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË VEPRON NGA DHE NËPËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE, SI HUAMARRËSI DHE ING BANK N.V, SI HUADHËNËSI

MARRËVESHJE HUAJE

Kjo Marrëveshje është lidhur më_____2007
Ndërmjet
1. Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron nga dhe nëpërmjet Ministrisë së tij të Financave, këtu i referuar, si "Huamarrësi";
2. ING Bank N.V, një institucion bankar që organizohet dhe ekziston si një kompani shtetërore me përgjegjësi të kufizuar, sipas ligjeve të Holandës, me seli në Amstelveenseweg 500, 1081 KL Amsterdam, Holandë, këtu i referuar, si "Huadhënësi";
Ndërsa:
A) Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri "Importuesi" dhe A. Hak International B. V.m Tricht, Holandë, një filial

me zotërim të plotë i A. Hak Beheer B.V., Tricht, Holandë.

"Kontraktuesi" më 9 shkurt 2007 kanë lidhur një kontratë mbi projektimin dhe ndërtimin për rehabilitimin e sistemit të shpërndarjes dhe sistemit të transportit të infrastrukturës ujore në Vlorë "Kontrata", ku ujësjellësi i Vlorës dhe ndërmarrja e ujërave të zeza janë përdoruesit fundorë.

Çmimi total që duhet të paguhet, nga Importuesi për Kontraktuesin sipas kontratës, është 24 371 000 euro (njëzet e katër milionë e treqind e shtatëdhjetë e një mijë euro) "Çmimi i kontratës",

Çmimi i kontratës do të paguhet nga Importuesi për Kontraktuesin: 1) me anë të një granti, të përkufizuar këtu e tutje ("Granti A" prej 12 679 500 eurosh; 2) me anë të transhit A të shërbimit të kredisë së eksportit (siç përkufizohet në këtë dokument) prej 11 691 500 eurosh. Synimi i Huamarrësit është të japë hua fondet nga transhi A për ujësjellësin e Vlorës dhe ndërmarrjen e ujërave të zeza.

Një shumë totale prej 3 655 650 eurosh, që përfaqëson 15% të çmimit të kontratës është e pagueshme si paradhënie nga Importuesi me ekzekutimin e kontratës dhe kjo shumë do të financohet si më poshtë: 2 437 100 euro do të paguhen nga granti A dhe 1 218 550 euro do të paguhen nga transhi A i shërbimit të kredisë së eksportit. Këto shuma janë të pagueshme në përputhje me kontratën dhe kryesisht në përputhje me programin e tërheqjeve, siç përcaktohet në bashkëlidhjen C.

Një shumë totale prej 20 715 350 eurosh që përfaqëson 85% të çmimit të kontratës, do të financohet si më poshtë:

a) një shumë prej 10 242 400 eurosh do të paguhet nga granti A me këste,

(dhe në përpjesëtim të drejtë me shumat që duhen paguar nga transhi A i shërbimit të kredisë së transportit), në përputhje me dhe në shkallën e dërgesave, siç përshkruhet në kontratë dhe kryesisht në përputhje me programin e tërheqjeve, të përcaktuar në bashkëlidhjen C;

b) një shumë prej 10 472 950 eurosh do të financohet nëpërmjet transhit A të shërbimit të kredisë së transportit dhe këtë shumë Huamarrësi e ka kërkuar nga Huadhënësi, dhe ky i fundit është i gatshëm t'i japë hua Huamarrësit, të pagueshme me këste (dhe në përpjesëtim të drejtë me shumat që duhen paguar nga granti A), në përputhje me dhe në shkallën e dërgesave, siç përshkruhet në kontratë dhe kryesisht në përputhje me programin e tërheqjeve për transhin A, siç përcaktohet në bashkëlidhjen C.

B) Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, Republika e Shqipërisë "Importuesi" dhe Haskoning Nederland B.V., Holandë "Konsulenti", më 8 shkurt 2007 kanë lidhur një kontratë mbi shërbimet, mbikëqyrjen e punimeve, përgatitjen e projekteve dhe mbështetjen institucionale për rehabilitimin e sistemit të shpërndarjes dhe sistemit të transportit të infrastrukturës ujore të Vlorës "Kontrata e shërbimit", ku ujësjellësi i Vlorës dhe ndërmarrja e ujërave të zeza janë përdoruesit fundorë.

Çmimi total që duhet paguar nga Importuesi për Konsulentin sipas kontratës së shërbimit është 1 865 000 euro (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë euro) (Çmimi i kontratës së shërbimit).

Çmimi i kontratës së shërbimit do të jetë i pagueshëm nga Importuesi për Konsulentin: 1) me anë të një granti, siç përcaktohet këtu e tutje "Granti B" prej 1 108 976 eurosh; dhe 2) me anë të transhit B të shërbimit të kredisë së eksportit (siç përcaktohet në këtë dokument) prej 756 024 eurosh. Synimi i Huamarrësit është të japë hua, fonde nga transhi B për ujësjellësin e Vlorës dhe ndërmarrjen e ujërave të zeza.

Një shumë totale prej 279 750 eurosh, që përfaqëson 15% të çmimit të kontratës së shërbimit, e pagueshme si paradhënie nga Importuesi me ekzekutimin e kontratës së shërbimit, shuma e së cilës do të financohet si më poshtë: 186 500 euro do të paguhen nga granti B dhe 93 250 euro do të paguhen nga transhi B i shërbimit të kredisë së eksportit. Këto shuma janë të pagueshme në përputhje me kontratën e shërbimit dhe kryesisht në përputhje me programin e tërheqjeve për transhin B, siç përcaktohet në bashkëlidhjen C.

Një shumë totale prej 1 585 250 eurosh që përfaqëson 85% të çmimit të kontratës së shërbimit do të financohet si më poshtë:

a) një shumë prej 922 476 eurosh do të paguhet nga granti B, e pagueshme me këste (dhe në përpjesëtim të drejtë me shumat që duhen paguar nga transhi B i shërbimit të kredisë së eksportit, siç përcaktohet në këtë dokument), në përputhje me dhe në shkallën e dërgesave, siç përshkruhet në kontratën e shërbimit dhe kryesisht në përputhje me programin e tërheqjeve, të përcaktuar në bashkëlidhjen C;

b) një shumë prej 662 774 eurosh do të financohet nëpërmjet transhit B të shërbimit ndihmës të kredisë së eksportit dhe këtë shumë Huamarrësi e ka kërkuar nga Huadhënësi dhe, ky i fundit është i gatshëm t'i japë hua Huamarrësit, të pagueshme me këste (dhe në përpjesëtim të drejtë me shumat që duhen paguar nga granti B), në përputhje me dhe në shkallën e dërgesave, siç përshkruhet në kontratën e shërbimit dhe kryesisht në përputhje me programin e tërheqjeve për transhin B, siç përcaktohet në bashkëlidhjen C.

Kjo Marrëveshje përcakton termat dhe kushtet në bazë të të cilave Huadhënësi është i përgatitur t'i japë hua shërbimit të kredisë së eksportit,

kështu, është rënë dakord si më poshtë:

1. Përkufizimet

1.1 Përveç përkufizimeve të mësipërme, do të aplikohen përkufizimet e mëposhtme:

Marrëveshje: nënkupton këtë Marrëveshje, duke përfshirë bashkëlidhjet A, B, C, D, E dhe F;

Shqipëria: nënkupton Republikën e Shqipërisë;

Atradius: nënkupton Biznesin Shtetëror Holandez Atradius N.V (kompaninë holandeze të sigurimeve të kredisë), Amsterdam, Holandë;

Autoritet: nënkupton çdo agjenci, institucion, organizatë, korporatë, qeveri, provincë, bashki ose person apo njësi tjetër publike, tatimore ose mbikombëtare, që ushtron çdo lloj kontrolli publik, qoftë *de fakto* apo *de jure*, mbi Huadhënësin, Huamarrësin ose çdo person apo njësi sipas kësaj Marrëveshjeje ose çdo dokument në lidhje me të cilin, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në Bankën Qendrore Holandeze, Bankën Qendrore Europiane, Bankën Qendrore të Shqipërisë dhe/ose çdo nënndarje politike ose autoritet tatimor të Komunitetit Europian ose pasardhës të tyre.

Periudha e vlefshmërisë

Transhi A: nënkupton periudhën që fillon që nga kjo datë dhe mbaron në periudhën më të hershme të një prej datave të mëposhtme:

i) datën në të cilën totali i shumave të parapaguara si më poshtë, do të jetë i barabartë me 11 691 500 euro;

ii) datën që hyn brenda 30 ditëve pas dorëzimit të vërtetimit të marrjes në dorëzim, në përputhje me kontratën; dhe

iii) 24 muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Periudha e vlefshmërisë

Transhi B: nënkupton periudhën që fillon që nga kjo datë dhe mbaron në periudhën më të hershme të një prej datave të mëposhtme:

i) datën në të cilën totali i shumave të parapaguara si më poshtë, do të jetë i barabartë me 756 024 euro;

ii) datën që hyn brenda 30 ditëve pas dorëzimit të faturës së fundit, në përputhje me kontratën e shërbimit; dhe

iii) 24 muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Huamarrësi: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, që vepron nga dhe nëpërmjet Ministrisë së tij të Financave;

Kostot e zvogëluara: nënkuptojnë shumën, (nëse ka) me anë të së cilës:

i) interesi që Huadhënësi duhet të ketë marrë për periudhën nga data e marrjes së të gjithë ose një pjese të huasë apo shumës së papaguar deri në ditën e fundit të periudhës së interesit rrjedhës në lidhje me atë hua ose shumë të papaguar, në rast se shuma e principalit ose shuma e papaguar e marrë është paguar në ditën e fundit të periudhës së interesit;

Tejkalon:

ii) shumën të cilën ai Huadhënës do të kishte qenë në gjendje të përftonte, duke vendosur një shumë të barabartë [me shumën e principalit ose shumën e papaguar] të marrë nga ai në depozitë me një bankë drejtuese në tregun përkatës ndërbankar për një periudhë që fillon në ditën e punës pas marrjes ose kompensimit dhe mbarimit në ditën e fundit të periudhës së interesit rrjedhës;

Ditë pune: nënkupton çdo ditë target (jo e shtunë ose e dielë), që është gjithashtu, një ditë në të cilën bankat janë të hapura për të operuar normalisht;

Kontrata/projekti: nënkupton marrëveshjen kontraktuale të lidhur ndërmjet Importuesit dhe Kontraktuesit të datës 9 shkurt 2007 dhe çdo amendim të saj, në lidhje me projektin dhe ndërtimin për rehabilitimin e sistemit të shpërndarjes dhe sistemit të transportit të infrastrukturës ujore Vlorë

Shqipëri;

Konsulenti: Haskoning Nederland B.V., Nijmegen, Holandë;

Kontraktuesi: A. Hak International B.V.; Tricht, Holandë;

Çmimi i kontratës: Çmimi që duhet paguar nga Importuesi për Kontraktuesin sipas kontratës, në shumën prej 24 371 000 eurosh;

Tërheqja: nënkupton një parapagim të bërë sipas zotimit financiar të transhit A ose zotimit financiar të transhit B, siç përshkruhet në klauzolën 4.1.

Programi i tërheqjeve

Transhi A: nënkupton programin për tërheqjet sipas zotimit financiar të transhit A, kryesisht siç përcaktohet në bashkëlidhjen C.

Programi i tërheqjeve

Transhi B: nënkupton programin për tërheqjet sipas zotimit financiar të transhit B, kryesisht siç përcaktohet në bashkëlidhjen C;

Marrëveshja EMU: Marrëveshja që themelon Komunitetin Ekonomik Europian, siç amendohet nga Marrëveshja mbi Bashkimin Europian (Traktati i Maastricht-it), duke përfshirë çdo instrument që amendon ose plotëson atë;

Data e hyrjes në fuqi: nënkupton datën në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi, siç njoftohet nga Huadhënësi Huamarrësit, sipas dispozitave të nenit 3.2 të kësaj Marrëveshjeje;

Barrë: nënkupton çdo peng, tarifë, të drejtë të mbajtjes së mallit ose interes tjetër sigurimi të çdo lloji që rrjedh në mënyra të ndryshme nga funksionimi i ligjit;

EUR dhe EURO: Euro që është monedha e ligjshme e Bashkimit Europian, siç vendoset nga Marrëveshja EMU;

EURIBOR: nënkupton, në lidhje me periudhën e interesit për të cilën interesi duhet të llogaritet në përputhje me klauzolën 5 ose 6: a) norma e interesit e shprehur si normë në vit, e barabartë me kursin e ofruar që tregohet në faqen e ekranit Reuters që tregon normën mesatare të Federatës Bankare të Bashkimit Europian për eurot (që është aktualisht faqja EURIBOR 01) për këtë periudhë në ose rreth orës 11 paradite në ditën e dytë të punës, para ditës së parë të kësaj periudhe interesi, ose nëse kjo faqe apo ky shërbim nuk është ose do të pushojë së qeni i vlefshëm ose i zbatueshëm, kjo faqe tjetër ose ky shërbim tjetër, për qëllim të shfaqjes në normën mesatare të Federatës Bankare të Bashkimit Europian, sipas përzgjedhjes së Huadhënësit; ose b) nëse ky kurs për euro tregohet dhe për periudhën përkatëse të interesit, ose norma nën “a” nuk reflekton saktë koston e financimit të Huadhënësit, ajo normë do të reflektojë koston aktuale të fondeve të Huadhënësit;

Ngjarja e mospagimit: nënkupton çdo rast të listuar në klauzolën 12.1 të kësaj Marrëveshjeje;

Shërbimi i kredisë së eksportit: nënkupton shërbimin e dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje që përbëhet prej totalit të zotimit financiar të transhit A dhe zotimit financiar të transhit B;

Borxh i jashtëm: nënkupton çdo detyrim për shlyerjen e parave të marra hua, qoftë të tashme ose të ardhme, reale ose të paparashikuara (duke përfshirë detyrimet e paparashikuara për shkak të ndonjë garancie ose ndonjë supozim tjetër përgjegjësie për detyrimet e palëve të treta), të emëruar ose me zgjedhjen e kreditorit përkatës, të pagueshëm në një monedhë të ndryshme nga monedha e ligjshme e Shqipërisë për kohën në vazhdim;

Data e fundit e shlyerjes: nënkupton datën e fundit të datës së shlyerjes së njëpasnjëshme gjashtë mujore, të treguar në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje, në të cilën secila dhe të gjitha shumat e papaguara sipas Marrëveshjes duhet të shlyhen plotësisht, dhe kjo datë do të jetë më e hershmja e: i) 120 (njëqind e njëzet muajve) pas datës së lëshimit të vërtetimit të marrjes në dorëzim; dhe ii) 1 janarin 2019;

Data e parë e shlyerjes: nënkupton datën e parë të datave të shlyerjes të njëpasnjëshme gjashtëmujore, të treguar në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje, në të cilën kësti i parë i shlyerjes bëhet i pagueshëm në kohën më të hershme të: i) gjashtë muajve pas datës së lëshimit të vërtetimit të marrjes në dorëzim; dhe ii) 1 korrikun 2009;

Granti A: nënkupton grantin nga Ministria e Punëve të Jashtme, që vepron në emër të Qeverisë së Holandës, përfaqësuar nga Stichting ORET ("ORET.nl") për Republikën e Shqipërisë, sipas marrëveshjes së grantit A;

Granti B: nënkupton grantin nga Ministria e Punëve të Jashtme, që vepron në emër të Qeverisë së Holandës, përfaqësuar nga Stichting ORET ("ORET.nl") për Republikën e Shqipërisë, sipas

marrëveshjes së grantit B;

Marrëveshja e grantit A: nënkupton Marrëveshjen e grantit të Shqipërisë nr.AL00013 për shumën prej 12 679 500 eurosh, ndërmjet Qeverisë së Holandës dhe Qeverisë së Shqipërisë;

Marrëveshja e grantit B: nënkupton Marrëveshjen e grantit të Shqipërisë nr.AL00012 për shumën prej 1 108 976 eurosh ndërmjet Qeverisë së Holandës dhe Qeverisë së Shqipërisë;

Importuesi: Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri;

Polica e sigurimit A: nënkupton një policë sigurimi kredie, që duhet lëshuar nga Atradius në favor të Huadhënësit, në lidhje me financimin sipas zotimit financiar të transhit A, të parashikuar në këtë Marrëveshje dhe kjo policë duhet të jetë sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Huadhënësin, siç njoftohet nga Huadhënësi Huamarrësit menjëherë pas marrjes së saj;

Polica e sigurimit B: nënkupton një policë sigurimi kredie, që duhet lëshuar nga Atradius në favor të Huadhënësit, në lidhje me financimin sipas zotimit financiar të transhit B, të parashikuar në këtë Marrëveshje dhe kjo policë duhet të jetë sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Huadhënësin, siç njoftohet nga Huadhënësi, Huamarrësit menjëherë pas marrjes së saj;

Premium i sigurimit A: nënkupton premiumin ose premiumet e sigurimit dhe kostot e ngjashme të pagueshme Atradiusit në lidhje me policën e sigurimit A;

Premium i sigurimit B: nënkupton premiumin ose premiumet e sigurimit dhe kostot e ngjashme të pagueshme Atradiusit në lidhje me policën e sigurimit B;

Data e pagesës së interesit: nënkupton ditën e fundit të çdo periudhe interesi;

Vërtetimi i përkohshëm i pagesës: nënkupton çdo vërtetim pagese, fature ose vërtetim të ngjashëm apo dokument të lëshuar nga Kontraktuesi dhe sigluar nga Konsulenti dhe nga Konsulenti për miratim në emër të Importuesit dhe që specifikon (ndër të tjera) një shumë ose shumat e pagueshme nga Importuesi Kontraktuesit, në përputhje me kushtet e kontratës;

Periudha e interesit: nënkupton, përveç rasteve të parashikuara ndryshe, ndonjë prej periudhave të përmendura në klauzolën 5.2;

Fatura: nënkupton çdo faturë apo vërtetim të ngjashëm ose dokument të lëshuar nga Konsulenti dhe sigluar për miratim nga Importuesi dhe që specifikon (ndër të tjera) një shumë ose shumat e pagueshme nga Importuesi Konsulentit, në përputhje me kushtet e kontratës së shërbimit;

Hua: nënkupton shumën e principalit të agregatit për kohën në vazhdim, të parapaguar dhe të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje dhe që merr parasysh çdo shlyerje dhe parapagim që duhet paguar sipas transhit A dhe transhit B;

Njoftimi i zvogëlimit të shumës, transhi A: nënkupton çdo kërkesë nga Huamarrësi për zvogëlimin e shumës sipas kësaj Marrëveshjeje në formularin e përcaktuar në bashkëlidhjen E të kësaj Marrëveshjeje, që specifikon shumat të cilat duhen tërhequr sipas transhit A dhe grantit A;

Njoftimi i zvogëlimit të shumës, transhi B: nënkupton çdo kërkesë nga Huamarrësi për zvogëlimin e shumës sipas kësaj Marrëveshjeje në formularin e përcaktuar në bashkëlidhjen F të kësaj Marrëveshjeje, që specifikon shumat të cilat duhen tërhequr sipas transhit B dhe grantit B;

Data e shlyerjes: nënkupton datën e kështit të shlyerjes së parë dhe datën në të cilën çdo kést i mëtejshëm shlyerjeje do të bëhet i pagueshëm dhe i detyrueshëm;

Periudha e shlyerjes: nënkupton periudhën që fillon në datën e shlyerjes së parë deri në datën e shlyerjes së fundit;

Kontrata e shërbimit/projekti: Marrëveshja kontraktuale e lidhur ndërmjet Importuesit dhe Haskoning Nederland B.V., Holandë e datës 8 shkurt 2007 dhe çdo amendim i saj, në lidhje me shërbimet, mbikëqyrjen e punimeve, përgatitjen e projekteve dhe mbështetjen institucionale për rehabilitimin e sistemit të shpërndarjes dhe sistemit të transportit të infrastrukturës ujore në Vlorë;

Çmimi i kontratës së shërbimit: nënkupton çmimin që duhet paguar nga Importuesi Konsulentit sipas kontratës së shërbimit, që është një shumë prej 1 865 000 eurosh;

Vërtetimi i marrjes në dorëzim: nënkupton vërtetimin e fundit të lëshuar nga Kontraktuesi dhe sigluar nga Importuesi dhe Konsulenti në emër të Importuesit për miratim, me qëllim konfirmimin e marrjes përfundimtare në dorëzim të projektit;

Target: nënkupton transfertën transeuropiane të automatizuar ekspres të shlyerjes bruto në kohë reale;

Dita e target: nënkupton çdo ditë në të cilën target është i hapur për shlyerjen e pagesës në

euro;

Transhi A: nënkupton transhin A të shërbimit të afatit të huasë, të mundësuar sipas kësaj Marrëveshjeje për financimin e një pjese të kontratës;

Transhi B: nënkupton transhin B të shërbimit të afatit të huasë, të mundësuar sipas kësaj Marrëveshjeje për financimin e një pjese të kontratës;

Zotimi financiar i transhit A: nënkupton detyrimin (duke iu nënshtruar termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje) e Huadhënësit për të vënë në dispozicion çdo shumë të përcaktuar më poshtë, brenda periudhës përkatëse të vlefshmërisë, deri në shumën e principalit të agregatit, të specifikuar në klauzolën 2.1 të saj;

Zotimi financiar i transhit B: nënkupton detyrimin (duke iu nënshtruar termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje) e Huadhënësit për të vënë në dispozicion çdo shumë të përcaktuar më poshtë, brenda periudhës përkatëse të vlefshmërisë, deri në shumën e principalit të agregatit, të specifikuar në klauzolën 2.1 të saj;

Holanda: nënkupton pjesën Europiane të Mbretërisë së Holandës;

Shuma e papaguar: nënkupton çdo shumë të detyrueshme dhe të pagueshme, por të papaguar nga Huadhënësi sipas Marrëveshjes.

1.2 Të gjitha pikat, klauzolat, kushtet dhe shtojcat janë, për sa kohë që nuk deklarohet ndryshe, pika, klauzola, kushte dhe shtojca të kësaj Marrëveshjeje.

1.3 Titujt në këtë Marrëveshje vendosen vetëm për efekt lehtësie dhe nuk do të merren parasysh gjatë interpretimit të kësaj Marrëveshjeje.

1.4 Të gjitha referencat ndaj orës, për sa kohë që nuk deklarohet ndryshe, i referohen orës së Amsterdamit.

1.5 Për sa kohë që përmbajtja nuk e kërkon ndryshe, fjalët që tregojnë numrin njëjës do të përfshijnë numrin shumës dhe anasjellas.

1.6 Referencat ndaj çdo dokumenti duhen interpretuar si referenca ndaj këtyre dokumenteve, siç amendohen herë pas here, përveçse në shkallën që konteksti e kërkon ndryshe.

2. Zotimi financiar

2.1 Huadhënësi bie dakord që t'i japë hua Humarrësit dhe Huamarrësi bie dakord që të marrë hua nga Huadhënësi një shumë totale, që nuk tejkalon 12 447 524 euro (dymbëdhjetë milionë e katërqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e njëzet e katër euro), duke iu nënshtruar termave dhe kushteve të parashtruara në këtë Marrëveshje. Zotimi financiar do të ndahet në një pjesë transhi A dhe një pjesë transhi B. Zotimi financiar për transhin A do të jetë një shumë që nuk tejkalon 11 691 500 euro dhe zotimi financiar për transhin B do të jetë një shumë, që nuk tejkalon 756 024 euro.

2.2 Huamarrësi do të përdorë shumat e zbritura sipas zotimit financiar të transhit A, ekskluzivisht për qëllim financimi prej 47.97% të çmimit të kontratës.

Huamarrësi do të përdorë shumat e zbritura sipas zotimit financiar të transhit B, ekskluzivisht për qëllim financimi prej 40.54% të çmimit të kontratës së shërbimit.

2.3 Tërheqjet totale sipas transhit A nuk do të tejkalojnë më të ultën: i) e 47,97% të çmimit të kontratës; dhe ii) shumën e zotimit financiar të transhit A, siç parashtrohet në klauzolën 2.1 më sipër.

Tërheqjet totale sipas transhit B nuk do të tejkalojnë më të ultën: i) e 40,54 % të çmimit të kontratës së shërbimit; dhe ii) shumën e zotimit financiar të transhit B, siç parashtrohet në klauzolën 2.1 më sipër.

3. Kushtet paraprirëse

3.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi sipas kushteve paraprirëse në përmbajtje të saj, që janë të pranueshme në formë dhe përmbajtje për Huadhënësin se:

i) Huadhënësi do të ketë marrë një opinion ligjor mbi Huamarrësin të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, kryesisht në formularin e bashkëlidhjes A;

ii) Huadhënësi do të ketë marrë një model firme të personit ose personave të emëruar që ka ose kanë ekzekutuar këtë Marrëveshje;

iii) Huadhënësi do të ketë marrë një vërtetim të Huamarrësit në lidhje me emrin dhe modelin e firmës së çdo personi, që do të nënshkruajë ndonjë prej dokumenteve që duhen nënshkruar sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit ose, sipas rastit, Importuesit, kryesisht në formularin e bashkëlidhjes D;

iv) Huadhënësi do të ketë marrë një kopje të kontratës (duke përfshirë kopje të çdo amendimi dhe shtese të saj);

v) Huadhënësi do të ketë marrë një kopje të kontratës së shërbimit (duke përfshirë kopje të çdo amendimi dhe shtese të saj);

vi) Huadhënësi do të ketë marrë një deklaratë me shkrim nga Kontraktuesi që vërteton se kontrata ka hyrë në fuqi dhe se Banka ORET.nl ka vënë në dispozicion grantin A;

vii) Huadhënësi do të ketë marrë një deklaratë me shkrim nga Konsulenti, që vërteton se kontrata e shërbimit ka hyrë në fuqi dhe se Banka ORET.nl ka vënë në dispozicion grantin B;

viii) Huadhënësi do të ketë marrë një policë sigurimi A nga Atradius në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Huadhënësi;

ix) Huadhënësi do të ketë marrë një policë sigurimi B nga Atradius në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Huadhënësi;

x) Polica e sigurimit A do të bëhet efektive dhe vazhdon të jetë e tillë;

xi) Polica e sigurimit B do të bëhet efektive dhe vazhdon të jetë e tillë;

xii) Huadhënësi do të ketë marrë nga Kontraktuesi premiumin e sigurimit, të referuar në klauzolën 14.1;

xiii) Huadhënësi do të ketë marrë nga Konsulenti premiumin e sigurimit, të referuar në klauzolën 14.1;

xiv) Huadhënësi do të ketë marrë nga Kontraktuesi tarifën e menaxhimit, të referuar në klauzolën 14.2;

xv) Huadhënësi do të ketë marrë nga Konsulenti tarifën e menaxhimit, të referuar në klauzolën 14.2;

xvi) Huadhënësi do të ketë marrë një letër nga ambasadori i Shqipërisë në Holandë, në formularin e bashkëlidhjes B;

xvii) Huadhënësi do të ketë marrë kopje të njësuara me origjinalin të çdo dokumenti që përbëjnë ose tregojnë miratime, licenca, aprovime ose autorizime apo regjistrime ose arkivime pranë çdo autoriteti ose strukture ndihmëse tjetër apo nëpunës në Shqipëri, të kërkuar për ekzekutimin, dorëzimin dhe/ose përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje nga ose në emër të Huamarrësit, ose për vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e saj, që Huadhënësi e çmon të nevojshme ose të dëshirueshme; dhe

xviii) Huadhënësi do të ketë marrë disa dokumente të angazhimit nga Kontraktuesi dhe Konsulenti.

3.2 Pas plotësimit të kushteve paraprirëse në klauzolën 3.1, kjo do t’i njoftohet menjëherë me shkrim Huamarrësit nga Huadhënësi.

3.3 Kushtet paraprirëse në përmbajtje të kësaj klauzole 3 duhet të plotësohen brenda 3 muajve pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje ose në një datë të mëvonshme, siç bihet dakord reciprokisht nga Huadhënësi dhe Huamarrësi.

4. Tërheqjet

4.1 Subjekti:

i) kushteve paraprirëse të parashtruara në klauzolën 3.1 që janë plotësuar dhe vazhdojnë të plotësohen dhe Huadhënësi ka njoftuar për këtë Huamarrësin në përputhje me klauzolën 3.2;

ii) asnjë ndodhi mosplotësimi pagese që ka ndodhur dhe asnjë rast tjetër që ka ndodhur që, me dhënien e njoftimit dhe/ose kalimin e kohës do të përbënte ndodhi mosplotësimi pagese;

iii) Huadhënësi pasi ka marrë dokumentet përkatëse për një tërheqje sipas transhit A nga Kontraktuesi ose dokumente përkatëse për një tërheqje sipas transhit B nga Konsulenti, jo më vonë se në mbyllje të orarit zyrtar në Amsterdam në ditën e tretë të punës, para datës në të cilën duhet të bëhet një tërheqje; dhe

iv) Atradius nuk ka informuar Huadhënësin se ndonjë tërheqje (e mëtejshme) që duhet të bëhet si më poshtë, nuk do të mbulohet nga polica e sigurimit A ose polica e sigurimit B;

Huadhënësi do të parapaguajë tërheqjet sipas transhit A ose transhit B, me kusht që:

a) tërheqjet të mund të bëhen në një ditë pune gjatë periudhës së vlefshmërisë;

b) tërheqjet mund të bëhen vetëm për qëllimin e parashtruar dhe duke iu nënshtruar kushteve të klauzolës 2.2;

c) shuma totale e të gjitha tërheqjeve nuk do të tejkalojë shumën maksimale të zotimit financiar sipas klauzolës 2.1 ose, sipas rastit, shumën e zotimit financiar, siç ulet në bazë të klauzolës 2.3;

d) Huadhënësi mund të refuzojë të vërë në dispozicion shumën e çdo tërheqjeje, qoftë tërësisht ose pjesërisht, nëse ORET.nl ka në kohën e kësaj tërheqjeje që nuk është vënë në dispozicion, një pjesë korresponduese të grantit përkatës, siç përcaktohet në bashkëlidhjen C; dhe

e) tërheqjet sipas transhit A ose transhit B dhe grantit A ose grantit B do të jenë gjithmonë në thelb, në përputhje me programin e zbatueshëm të tërheqjeve në bashkëlidhjen C.

4.2 Në këtë mënyrë Huamarrësi, në formë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar autorizon Huadhënësin për të paguar shumën e çdo tërheqjeje sipas transhit A, sipas klauzolës 4.1, në mënyrë të drejtpërdrejtë Kontraktuesit, në emër të dhe për llogari të Huamarrësit, në përputhje me programin e tërheqjeve të transhit A, siç përmendet në bashkëlidhjen C kundrejt paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme:

- vërtetim pagese të përkohshme;
- njoftim për zbritjen e shumës, transhi A;
- kërkesa korresponduese të tërheqjeve ndaj ORET.nl sipas grantit A.

Në këtë mënyrë, Huamarrësi, në formë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar autorizon Huadhënësin për të paguar shumën e çdo tërheqjeje sipas transhit B, sipas klauzolës 4.1 në mënyrë të drejtpërdrejtë Konsulentit, në emër të dhe për llogari të Huamarrësit, në përputhje me programin e tërheqjeve të transhit B, siç përmendet në bashkëlidhjen C kundrejt paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme:

- fatura;
- njoftimi për zbritjen e shumës, transhi B;
- kërkesa korresponduese të tërheqjeve ndaj ORET.nl sipas grantit B.

4.3 Nëse ndonjë tërheqje sipas transhit A ose transhit B nuk është bërë në mbyllje të orarit zyrtar në Amsterdam në ditën e punës para ditës së fundit të periudhës përkatëse të vlefshmërisë, pjesët e papërdorura të zotimeve financiare të transhit A dhe/ose transhit B do të anulohen dhe më pas nuk do të vihen në dispozicion të Huamarrësit për huamarrje.

5. Interesi

5.1 Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit interesin mbi huanë, që duhet llogaritur në një normë të bazuar në EURIBOR, të shtuar me një kufi prej 0.65% (gjashtëdhjetë e pesë pikë bazë) në vit dhe të pagueshme në ditën e fundit të periudhave pasardhëse kohore (Periudhat e interesit), në përputhje me kushtet e mëposhtme.

5.2 Çdo periudhë interesi do të ketë një kohëzgjatje prej gjashtë muajsh, por në mënyrë që:

i) periudha e parë e interesit do të fillojë në datën në të cilën tërheqja e parë bëhet si më poshtë;

ii) në rastin e çdo tërheqjeje të ndryshme nga e para, periudha e parë e interesit do të fillojë në datën e kësaj tërheqjeje dhe do të përfundojë në datën e mbarimit të periudhës, më pas aktuale të interesit në lidhje me huanë e papaguar në datën e kësaj tërheqjeje;

iii) çdo periudhë e mëtejshme interesi do të fillojë në datën e skadimit të periudhës menjëherë paraardhëse të interesit;

iv) nëse ndonjë periudhë interesi do të mbaronte ndryshe në një ditë, e cila nuk është ditë pune, ajo periudhë interesi do të shtrihet në ditën tjetër pasardhëse që është ditë pune, për sa kohë që dita tjetër pasardhëse e punës përkon në muaj tjetër kalendarik në të cilin periudha e interesit do të përfundojë me ditën menjëherë paraardhëse të punës;

v) duke iu nënshtruar kushteve (ii) dhe (vi) të kësaj klauzole 5.2, çdo periudhë interesi që fillon në ditën e fundit të muajit kalendarik dhe çdo periudhë interesi që fillon në një ditë për të cilën nuk ka ditë numerikisht korresponduese në muajin kalendarik, gjashtë muaj pas fillimit të kësaj periudhe interesi, do të mbarojë në ditën e fundit të punës të muajit kalendarik, gjashtë muaj pas fillimit të kësaj periudhe interesi;

vi) çdo periudhë interesi që, pa këtë kusht (vi), do të fillonte para, por do të përfundonte pas çdo date shlyerjeje, do të shkurtohet për të përfunduar në këtë datë shlyerjeje.

5.3 Interesi do të llogaritet mbi huanë mbi bazën e ditëve aktuale të kaluara dhe një viti 360 ditësh dhe do të shtohet nga dita në ditë.

5.4 Në fund të çdo periudhe interesi dhe me çdo tërheqje, Huadhënësi do të informojë Huamarrësin me teleks ose faks për shumën e interesit të pagueshëm Huadhënësit, në lidhje me periudhën e mëpasshme të interesit për huanë dhe/ose tërheqjet, sipas rastit.

5.5 Opsioni i normës fikse të interesit: çdo datë shlyerjeje, Huamarrësi do të ketë opsionin për të konvertuar normën e ndryshueshme të interesit mbi huanë në një normë fikse interesi, duke iu nënshtruar vlefshmërisë, në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) Huadhënësi do të marrë një kërkesë me shkrim nga Huamarrësi deri minimumi 30 (tridhjetë) ditë pune, por jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune para datës së synuar të konvertimit të interesit në ose para orës 22.00 para asaj date shlyerjeje;

b) në ditën e marrjes nga Huadhënësi të kësaj kërkese me shkrim të Huamarrësit, Huadhënësi do t'i ofrojë Huamarrësit në ose para orës 14.00 atë ditë një kurs fiks për një normë fikse të interesit. Kjo normë fikse interesi mbi huanë do të përcaktohet nga (a) një kurs për euro për periudhën që mbetet huasë së shtuar me (b) një kufi prej 0.65% (gjashtëdhjetë e pesë pikë bazë) në vit;

c) Huamarrësi do t'i japë njoftim me shkrim Huadhënësit në lidhje me këtë konvertim të synuar të interesit në ose para orës 16.00 atë ditë, duke pranuar kështu kursin fiks të ofruar Huamarrësit nga Huadhënësi, në përputhje me klauzolën (b) më sipër, (ky njoftim duhet të jetë i parevokueshëm dhe përfundimtar për Huamarrësin);

d) interesi do të mbetet fiks për të gjithë periudhën e shlyerjes që mbetet. Interesi fiks do të jetë i detyrueshëm dhe i pagueshëm mbi bazë gjashtëmujore në shuma të prapambetura në datat e shlyerjes;

e) në rast të ndonjë parapagimi gjatë periudhës së mbetur të shlyerjes (referuar sipas pikës d më sipër) Huamarrësi do të paguajë kostot e zvogëluara.

6. Shlyerja dhe parapagimi

6.1 Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, shuma e huasë së papaguar në mbyllje të orarit zyrtar në Amsterdam, ditën e fundit të periudhës së vlefshmërisë, do të shlyhet plotësisht nga Huamarrësi me 20 (njëzet) këste të barabarta gjashtëmujore të njëpasnjëshme në datat e shlyerjes.

6.2 Parapagimet sipas kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohen kostove të zvogëluara.

7. Përfaqësimet dhe garancitë

7.1 Huamarrësi përfaqëson dhe garanton Huadhënësin se:

i) Huamarrësi ka kompetencë dhe autoritet të plotë ligjor për të ekzekutuar dhe dorëzuar këtë Marrëveshje, për t'i marrë hua Huamarrësit, siç parashikohet në të dhe për të përmbushur dhe zbatuar dispozitat në lidhje me të, që duhen përmbushur ose zbatuar dhe që të gjitha veprimet e tjera legjislative, administrative dhe qeveritare të kërkuara për të autorizuar transaksionet e shqyrtuara për këtë arsye dhe ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje nga Huamarrësi të jenë bërë rregullisht dhe të jenë me fuqi dhe efekt të plotë;

ii) ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje dhe transaksionet e shqyrtuara për këtë arsye nga Huamarrësi nuk shkelin dhe nuk do të: a) shkelin ndonjë dispozitë të Kushtetutës së Shqipërisë ose ndonjë marrëveshje të zbatueshme në të cilën Shqipëria është palë, apo ndonjë ligj, dekret, rregullore, komunikatë, urdhëresë ose akt tjetër të ngjashëm ekzistues të Shqipërisë, ndonjë vendim të ndonjë gjykate, ose gjykate tjetër apo autoriteti rregullator ose ndonjë vendim të zbatueshëm arbitrazhi të Shqipërisë ose në Shqipëri; ose b) nuk shkelin ndonjë marrëveshje ekzistuese ose instrument tjetër në të cilin Huamarrësi është palë, ose që është përfundimtar për Huamarrësin;

iii) të gjitha miratimet, licencat, aprovimet ose autorizimet, ose regjistrimi apo arkivimi pranë ndonjë autoriteti, strukture ndihmëse ose nëpunësi të Shqipërisë apo në Shqipëri, të kërkuara për ekzekutimin, dorëzimin ose përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje nga Huamarrësi për vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë në lidhje me të, janë në fuqi dhe efekt të plotë;

iv) kjo Marrëveshje përbën detyrime ligjore, të vlefshme dhe përfundimtare të Huamarrësit, të zbatueshme përkundrejt Huamarrësit në përputhje me kushtet e tij dhe borxhi i Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje është dhe do të jetë në të gjitha kohët borxhi i tij i drejtpërdrejtë, i pakushtëzuar dhe i përgjithshëm;

v) personi që ekzekuton dhe dorëzon këtë Marrëveshje, (emri dhe modeli i nënshkrimit të të cilit i është dorëzuar Huadhënësit në përputhje me klauzolën 3.1 (ii) është plotësisht i autorizuar për të ekzekutuar këtë për dhe në emër të Huamarrësit dhe secili prej nëpunësve të Huamarrësit, të treguar në

vërtetimin e lëshuar në emër të Huamarrësit në përputhje me klauzolën 3.1 (iii) dhe në çdo version të përditësuar të nxjerrë në emër të Huamarrësit, në përputhje me klauzolën 8.1 (ii), ka të drejtën, kompetencën dhe autoritetin për të nënshkruar në emër të Huamarrësit të gjitha njoftimet, komunikimet dhe vërtetimet që duhen dhënë ose lëshuar nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje;

vi) Huamarrësi i nënshtrohet ligjit civil dhe tregtar në lidhje me detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje. Ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje nga Huamarrësi dhe transaksionet e shqyrtuara për këtë arsye, përbëjnë akte private dhe tregtare, sesa akte publike ose qeveritare. As Huamarrësi, as ndonjë prej aseteve të tij (duke përjashtuar asetet diplomatike dhe asetet e tjera në sferën publike) nuk ka sipas ligjit të Shqipërisë ndonjë të drejtë imuniteti nga juridiksioni të ndonjë gjykate, padi, ekzekutim pas një vendimi, kompensim ose ndonjë proces tjetër ligjor (qoftë nëpërmjet paraqitjes së procesit ose njoftimit, apo në mënyrë tjetër) në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

vii) nënshtrimi i parevokueshëm i Huamarrësit ndaj juridiksionit të gjykatave të Amsterdamit dhe marrëveshja e Huamarrësit që kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin e Holandës, janë ligjore, të vlefshme dhe detyruese dhe do të njiheshin dhe zbatoheshin nga gjykatat e Shqipërisë në rast të ndonjë procedimi në lidhje me këtë Marrëveshje në Shqipëri;

viii) asnjë ndodhi mosplotësimi pagese nuk ka ndodhur, asnjë ndodhi që me dhënien e njoftimit dhe/ose kalimin e kohës do të përbënte një ndodhi mosplotësimi pagese;

ix) asnjë çështje gjyqësore ose procedim administrativ nuk është në proces ose, sipas dijenisë së Huamarrësit, nuk është kërcënuar me shkrim kundër këtij ose ndonjë prej aseteve të tij që në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të cenojë seriozisht mundësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij financiare sipas kësaj Marrëveshjeje ose që vë në dyshim ligjshmërinë, vlefshmërinë ose efektin detyrues të ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje;

x) sipas ligjit të Shqipërisë, në fuqi, në datën e kësaj Marrëveshjeje, për të siguruar zbatueshmërinë ose pranueshmërinë në dëshmi të kësaj Marrëveshjeje në Shqipëri, nuk është e nevojshme që kjo Marrëveshje apo ndonjë dokument tjetër i shqyrtuar për këtë arsye, të arkivohet ose regjistrohet, ose që ndonjë taksë apo tarifë të paguhet në Shqipëri;

xi) që në datën e kësaj Marrëveshjeje, asnjë pullë apo taksa ose tarifa të tjera në lidhje me përgatitjen, ekzekutimin, dorëzimin, arkivimin, regjistrimin, përmbushjen ose zbatimin nga Huamarrësi dhe/ose Huadhënësi të kësaj Marrëveshjeje, nuk kërkohet në Shqipëri ose nga ndonjë autoritet tatimor ose fiskal përkatës;

xii) që në datën e kësaj Marrëveshjeje, nuk ka të ardhura ose taksë tjetër në Shqipëri, apo ndonjë autoritet tatimor ose fiskal përkatës, të vendosur nga zbritjet ose në një mënyrë tjetër, që vendoset mbi çdo pagesë që duhet të bëhet nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje ose që vendoset mbi ose në bazë të ekzekutimit, ose dorëzimit të kësaj Marrëveshjeje nga Huamarrësi, ose ndonjë dokument tjetër që duhet ekzekutuar dhe dorëzuar si më poshtë nga Huamarrësi;

xiii) detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje klasifikohen të paktën *pari passu* në prioritet të pagesës me të gjitha borxhet e tjera ose borxhin e jashtëm të Huamarrësit;

xiv) nuk ka dhe nuk do të ketë si rezultat i ekzekutimit, dorëzimit ose përmbushjes së kësaj Marrëveshjeje, ndonjë barrë mbi të gjitha ose pjesën kryesore të të ardhurave ose aseteve të tashme ose të ardhshme të Huamarrësit;

xv) përzgjedhja nga Huamarrësi e një vendbanimi në Holandë, për qëllim të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me klauzolën 21.2 në lidhje me të, është autorizuar, ekzekutuar dhe dorëzuar rregullisht dhe detyrimi i Huamarrësit për të zgjedhur vendbanim në Holandë për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, është i ligjshëm, i vlefshëm dhe detyrues;

xvi) Huamarrësi nuk është në mosplotësim pagese sipas ndonjë akti, marrëveshjeje ose kontrate në të cilën ai është palë, që është detyrues mbi Huamarrësin ose ndonjë prej aseteve të tij, mosplotësimi i pagesës së të cilave do të kishte pasoja të rënda materiale mbi Huamarrësin ose që do të cenonte seriozisht mundësinë e tij për të përmbushur dhe zbatuar në mënyrën e duhur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

xvii) nuk është e nevojshme ose e rekomandueshme sipas ligjeve të Shqipërisë: a) me qëllim që t'i mundësojë Huadhënësit zbatimin e të drejtave të tij të treguara më poshtë; ose b) vetëm për shkak të ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje; ose c) përmbushjes nga Huadhënësi të detyrimeve të tij si më poshtë që secili prej tyre, duhet të jetë i licencuar, i kualifikuar ose i autorizuar ndryshe për të

vazhduar biznesin në Shqipëri; dhe

xviii) Huadhënësi nuk konsiderohet dhe nuk do të konsiderohet të jetë rezident me vendbanim, që vazhdon biznesin ose t'i nënshtrohet apo të jetë përgjegjës për ndonjë taksë, tatim, tarifë ose zbritje brenda Shqipërisë, për arsye vetëm të negocimit, përgatitjes, ekzekutimit, përmbushjes, zbatimit dhe/ose marrjes së çdo pagese sipas kësaj Marrëveshjeje.

7.2 Përfaqësimi dhe garancitë e parashtruara në klauzolën 7.1 të saj, do të zgjasin edhe pas lidhjes së kësaj Marrëveshjeje dhe çdo tërheqjeje, si më poshtë dhe do të çmohet që duhet të përsëriten në çdo datë në të cilën bëhet një tërheqje dhe në çdo datë pagese interesi dhe datë shlyerjeje, sikur të bëheshin në secilën prej këtyre herëve, duke iu referuar fakteve dhe rrethanave ekzistuese në atë kohë.

8. Angazhimet

8.1 Për sa kohë që huaja ose pjesë të saj mbeten të patërhequra ose huaja apo ndonjë pjesë e saj mbetet e papaguar ose ndonjë shumë tjetër është ose bëhet e pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi:

i) do t'i japë Huadhënësit, sipas kërkesës së arsyeshme të këtij të fundit, çdo informacion në lidhje me kontratën ose kontratën e shërbimit, siç mund të jetë e përshtatshme në shkallën e mundshme për Huamarrësin dhe çdo informacion në lidhje me gjendjen e tij të përgjithshme ekonomike dhe financiare;

ii) do t'i japë Huadhënësit herë pas here (në shkallën e nevojshme) një vërtetim që përcakton emrat, funksionet dhe modelet e nënshkrimeve të personit ose personave të emëruar nga Huamarrësi dhe që zëvendësojnë personat, emrat, titujt, funksionet dhe autorizimet e të cilëve specifikohen në vërtetimin e referuar në klauzolën 3.1 (iii);

iii) do të përftojë dhe mbajë në fuqi të plotë çdo autorizim, miratim, aprovim, licencë, përjashtim dhe përmbushë çdo arkivim ose regjistrim pranë ndonjë gjykate të Shqipërisë, ose ndonjë autoriteti apo organizate gjyqësore, administrative, qeveritare apo autoriteti tjetër në Shqipëri, që është ose mund të bëhet e nevojshme, me qëllim që Huamarrësi të mund të përmbushë dhe zbatojë të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe t'i japë Huadhënësit kopje të çdo autorizimi, miratimi, aprovimi, licence ose përjashtimi;

iv) menjëherë pas vënies në dijeni të kësaj, t'i japë Huadhënësit njoftim me shkrim në lidhje me çdo ndodhi mosplotësimi pagese dhe çdo rast tjetër, që me dhënien e njoftimit dhe/ose kalimit të kohës, do të përbënte ndodhi mosplotësimi pagese, duke informuar njëkohësisht Huadhënësin për çdo veprim të ndërmarrë ose që propozohet të ndërmerret në lidhje me këtë;

v) informojë Huadhënësin: a) në lidhje me të gjitha amendimet dhe shtesat materiale të kontratës ose kontratës së shërbimit; dhe b) për çdo çështje gjyqësore ose procedim administrativ, të mbetur pezull ose të kërcënuar, që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të cenojë mundësinë e Huamarrësit për përmbushjen e detyrimeve të tij financiare sipas kësaj Marrëveshjeje dhe/ose kontratës apo kontratës së shërbimit; dhe c) për çdo informacion tjetër financiar, statistikor, ligjor dhe të përgjithshëm rreth Huamarrësit, siç mund ta kërkojë Huadhënësi, herë pas here, në mënyrë të arsyeshme; dhe

vi) nëse në ndonjë kohë, nuk do të ketë ambasadë të Republikës së Shqipërisë në Holandë ose Belgjikë, siç parashikohet në klauzolën 21.2, të zgjedhë ndonjë vendbanim tjetër në Holandë ose Belgjikë.

8.2 Për sa kohë që huaja ose pjesë të saj mbeten të patërhequra, ose huaja ose pjesë të saj mbeten të papaguara apo ndonjë shumë tjetër është ose bëhet e pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi zotohet që të gjitha detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje të klasifikohen në të gjitha kohërat të paktën *pari passu* me të gjithë borxhin e jashtëm ekzistues ose të ardhshëm të Huamarrësit dhe do të sigurohen në mënyrë të barabartë, nëse Huamarrësi krijon ose lejon krijimin e ndonjë barre mbi të ardhurat ose asetet e tij ose ndonjë të ardhure apo aseti të ndonjë autoriteti, si sigurim për çdo borxh të jashtëm.

9. Taksat

i) të gjitha pagesat që duhet të bëhen nga Huamarrësi si më poshtë, do të bëhen pa zbritje ose, me mirëkuptimin e palëve, që asnjë taksë, tatim apo tarifë tjetër të mos jetë e zbatueshme ndaj pagesave të mësipërme dhe të përfaqësohet dhe garantohet shprehimisht nga Huamarrësi që asnjë taksë mbi të ardhurat ose taksë korporate, e vendosur nga ose në Shqipëri, të mos zbatohet ndaj pagesave të treguara më poshtë;

ii) nëse në ndonjë kohë, Huamarrësit i kërkohet nga ligji i zbatueshëm të bëjë ndonjë zbritje

ose duke zbritur nga ndonjë pagesë e treguar më poshtë, shuma e pagueshme nga Huamarrësi në lidhje me të cilën kërkohet të bëhet ajo zbritje, do të rritet në shkallën e nevojshme për të siguruar se pas bërjes së zbritjes së kërkuar, Huadhënësi ka marrë dhe siguruar (i çliruar nga çdo përgjegjësi në lidhje me atë zbritje) një shumë neto të barabartë me shumën që do të kishte marrë dhe siguruar, nëse kjo zbritje nuk do të ishte bërë ose nuk do të kërkohej të bëhej;

iii) pa cenuar dispozitat e klauzolave 9.1 (i) dhe (ii), nëse Huadhënësit i kërkohet të bëjë ndonjë pagesë për shkak të taksës (jo taksë e vendosur mbi të ardhurat neto të Huadhënësit nga juridiksioni në të cilin është përfshirë, ose në të cilin ndodhet zyra përkatëse e huadhënies), ose ndryshe mbi ose në lidhje me ndonjë shumë të marrë ose që është për t'u marrë nga ai si më poshtë (duke përfshirë, pa kufizim, çdo shumë të marrë ose që është për t'u marrë sipas kësaj klauzole 9.1), ose ndonjë përgjegjësi në lidhje me ndonjë prej këtyre pagesave, konfirmohet, vendoset ose vlerësohet kundrejt Huadhënësit, Huamarrësi, me kërkesë të Huadhënësit, do të dëmshpërblejë menjëherë Huadhënësin kundrejt kësaj pagese ose përgjegjësie, së bashku me interesin, gjobat dhe shpenzimet e pagueshme ose të pësuara në lidhje me këtë;

iv) nëse Huadhënësi synon të bëjë një kërkesë sipas klauzolës 9.1 (iii), ai do të njoftojë Huamarrësin në lidhje me ndodhinë për shkak të së cilës është i autorizuar të bëjë këtë kërkesë, me kusht që asgjë në të nuk do t'i kërkojë Huadhënësit të zbulojë ndonjë informacion konfidencial në lidhje me organizimin e punëve të tij.

9.2 Nëse Huamarrësit i kërkohet të bëjë pagesa për taksa ose tarifa të tjera, siç parashikohet në klauzolën 9.1, atëherë Huamarrësi do t'i konfirmojë Huadhënësit se të gjitha këto taksa ose tarifa të tjera, janë paguar.

10. Paligjshmëria

10.1 Nëse bëhet e paligjshme për Huadhënësit për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të tij të treguara më poshtë kundrejt Huamarrësit ose për të financuar ndonjë tërheqje ose hua, sipas rastit, ai (në shkallën që është në dijeni të kësaj) do t'i paraqesë Huamarrësit prova të kësaj paligjshmërie dhe do të konsultohet me Huamarrësin, me synim arritjen e një zgjidhjeje reciprokisht të pranueshme. Nëse një zgjidhje e tillë nuk arrihet brenda dhjetë ditëve pune të kësaj prove që paraqitet:

i) Huadhënësi do të çlirohet nga detyrimet e tij për të vënë në dispozicion ndonjë tërheqje të mëtejshme dhe zotimi financiar do të anulohet; dhe

ii) Huamarrësi, brenda pesëmbëdhjetë ditëve pune pas paraqitjes së këtyre provave, do t'i parapaguajë Huadhënësit huanë në pajtim të plotë dhe duke iu nënshtruar dispozitave të klauzolës 10.2.

10.2 Kur huaja ose një pjesë e saj duhet të parapaguhet nga Huamarrësi sipas dispozitave të kësaj klauzole 10, Huamarrësi, njëkohësisht me këtë parapagesë, do t'i paguajë Huadhënësit interesin e shtuar mbi huanë, duke përfshirë çdo tarifë, kosto të zvogëluar, kosto dhe shpenzime.

11. Pagesa

11.1 Çdo pagesë që duhet bërë nga Huamarrësi si më poshtë, siç parashikohet në klauzolën 11.6, do t'i bëhet Huadhënësit në euro lehtësisht të transferueshme dhe të konvertueshme jo më vonë se ora 11.00 paradite, në datën e caktuar në favor të ING Bank N.V., Amsterdam, me kodin INGBNL2A për kredi të mëtejshme në numrin e llogarisë 50912216, duke cituar referencën SFAS/HE03.04/SEF/Albania/Hak/Haskoning ose një llogari tjetër të tillë, siç mund t'i njoftohet herë pas here Huamarrësit nga Huadhënësi me një njoftim me shkrim 15 ditë para.

11.2 Nëse një datë në të cilën ndonjë shumë sipas kësaj Marrëveshjeje është e detyrueshme dhe e pagueshme nuk është ditë pune, atëherë data për pagesën e kësaj shume do të shtyhet automatikisht në ditën tjetër pasardhëse të punës, për sa kohë që kjo ditë tjetër pasardhëse pune nuk do të përfshihet në një muaj tjetër kalendarik dhe në këtë rast, kjo shumë do të jetë e pagueshme në ditën paraardhëse të punës dhe me kusht që më tej, nëse interesi është i pagueshëm mbi këtë shumë, interesi do të jetë i pagueshëm në lidhje me çdo shtyrje të ndonjë date të detyrueshme, siç është cituar më sipër.

11.3 Në rast të pamundësisë së Huamarrësit për pagimin në datën e caktuar të çdo shume të detyruar dhe të pagueshme si më poshtë, Huamarrësi do të paguajë interes me kërkesë të Huadhënësit mbi këtë shumë, interesi i të cilës do të llogaritet duke iu referuar periudhave të mëpasshme të interesit, e para e të cilave fillon në datën e këtij mosplotësimi pagese dhe e fundit mbaron në datën e pagesës aktuale (prapa si dhe para vendimit) siç kërkohet nga Huadhënësi, sipas zgjedhjes së tij të

padiskutueshme. Ky interes do të llogaritet me një normë p.a. të caktuar nga Huadhënësi për të qenë totali i një kufiri prej 2.5% (dy dhe gjysmë për qind) në vit dhe EURIBOR.

11.4 Interesi në normën e referuar në klauzolën 11.3 do të llogaritet mbi çdo shumë të papaguar nga dita në ditë, mbi bazën e ditëve aktuale të kaluara dhe një viti prej 360 ditësh.

11.5 Pa cenuar sa më sipër, Huamarrësi do të dëmshpërblejë Huadhënësin kundrejt të gjitha humbjeve dhe shpenzimeve (duke përfshirë humbjet e pësuara në likuidimin ose përdorimin e depozitave të përftuara, të rregulluara ose të përdorura për të realizuar, financuar ose mbështetur huanë ose ndonjë pjesë të saj) që ndonjë prej tyre mund të pësojë si rezultat i kësaj pamundësie nga Huamarrësi, secili vërtetim (duke specifikuar në detaje të arsyeshme shumat e pretenduara) i Huadhënësit, përveç ndonjë gabimi të dukshëm, do të jetë vendimtar dhe detyrues mbi Huamarrësin.

Çdo shumë e marrë nga Huadhënësi si rezultat i ndonjë pagese sipas klauzolës 11.3 do të zvogëlojë paralelisht shumën e pagueshme Huadhënësit sipas kësaj klauzole 11.5.

11.6 Euro është monedha e llogarisë dhe pagesës për secilën dhe çdo shumë në çdo kohë pagese nga Huamarrësi si më poshtë, me kusht që:

i) secila pagesë në lidhje me kostot dhe shpenzimet të bëhet në monedhën në të cilën ato janë bërë;

ii) çdo pagesë sipas klauzolës 9.1 (iii) do të bëhet në monedhën e specifikuar nga Huadhënësi; dhe

iii) çdo shumë e shprehur që duhet të bëhet e pagueshme në një monedhë të ndryshme nga euro, do të paguhet në llogarinë dhe në vendin e njoftuar herë pas here Huamarrësit nga Huadhënësi.

11.7 Nëse sipas një vendimi ose për ndonjë arsye tjetër, një pagesë do të bëhet në një monedhë ose vend të ndryshëm nga ai i referuar në të dhe kjo pagesë pas konvertimit të menjëhershëm në euro (ose, sipas rastit, ndonjë monedhë tjetër të caktuar nga Huadhënësi në klauzolën 11.6) dhe transferimit në vendin e specifikuar në klauzolën 11.1 (ose sipas rastit, vendin e njoftuar Huamarrësit nga Huadhënësi në përputhje me klauzolën 11.6 (iii)) nuk plotëson shumën për t'u paguar si më poshtë, Huamarrësi pas njoftimit në lidhje me të, do ta dëmshpërblejë Huadhënësin për këtë mungesë dhe Huadhënësi do të ketë një klauzolë të veçantë të veprimit në lidhje me këtë.

11.8 Të gjitha shumat e paguara nga Huadhënësi, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të çmohen të jenë në shlyerjen e zërave të mëposhtëm dhe në rendin e mëposhtëm:

a) tarifat, kostot dhe shpenzimet;

b) tarifat;

c) dëmshpërblimet;

d) interesi mbi shumat e vonuara;

e) interesi;

f) shuma e principalit të huasë.

12. Ndodhitë e mosplotësimit të pagesës

12.1 Pas ndonjë prej ndodhive të mëposhtme të mosplotësimit të pagesës:

i) nëse Huamarrësi nuk do të ketë paguar rregullisht ndonjë shumë (qoftë të principalit, interesit ose ndonjë shumë tjetër) që ka borxh sipas kësaj Marrëveshjeje brenda 7 (shtatë) ditëve pas datës për pagimin e kësaj shume;

ii) nëse Huamarrësi nuk arrin të plotësojë pagesën në përmbushjen ose zbatimin e rregullt të ndonjë zotimi ose detyrimi sipas kësaj Marrëveshjeje (të ndryshme nga pamundësia nga ana e Huamarrësit për të paguar ndonjë shumë të treguar më poshtë, kur është e detyrueshme dhe e pagueshme) dhe, nëse ky mosplotësim pagese është në gjendje të kompensohet, ky nuk do të ketë qenë tërësisht i kompensuar brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve më pas, ose nëse ndonjë përfaqësim apo garanci e bërë nga Huamarrësi në këtë Marrëveshje rezulton të jetë i pavërtetë, jokorrekt ose çorientues në ndonjë aspekt material, kur bëhet ose mendohet të përsëritet;

iii) nëse Huamarrësi nuk do të arrijë të përmbushë ndonjë pakt ose marrëveshje sipas ndonjë marrëveshjeje ose instrumenti (të ndryshëm nga kjo Marrëveshje), që paraqet ose siguron ose që ka lidhje me ndonjë borxh të jashtëm të Huamarrësit, dhe ky mosplotësim pagese, nëse është në gjendje të kompensohet, mbetet i pakompensuar për një periudhë që tejkalon 15 (pesëmbëdhjetë) ditë;

iv) nëse kjo Marrëveshje ose ndonjë instrument tjetër apo dokumente të dorëzuara si më poshtë, nuk janë autorizuar, ekzekutuar dhe dorëzuar rregullisht dhe nuk përbëjnë detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese të Huamarrësit, të zbatueshme kundrejt Huamarrësit në Shqipëri në përputhje

me kushtet e saj;

v) nëse kjo Marrëveshje ose ndonjë prej dispozitave në një kohë të caktuar, për ndonjë arsye, do të pushojë së qenuri në fuqi dhe efekt të plotë, do të deklarohet e pavlefshme ose do të hidhet poshtë, ose vlefshmëria apo zbatueshmëria e saj në çdo kohë do të kundërshtohet nga Huamarrësi ose Huamarrësi do të mohojë që ka ndonjë përgjegjësi, ose përgjegjësi të mëtejshme, apo detyrim si më poshtë;

vi) nëse një moratorium i përgjithshëm deklarohet në pagesë të (ose pjesë të) borxhit të jashtëm të Huamarrësit, ose nëse Huamarrësi pranon me shkrim pamundësinë e tij për të përmbushur detyrimet e tij të pagesës në lidhje me (ndonjë pjesë të) borxhit të tij të jashtëm ose fillon negociata me ndonjë ose më shumë prej kreditorëve të tij, me synim rirregullimin ose riprogramimin e përgjithshëm të borxhit të tij të jashtëm;

vii) nëse transferimi i monedhës së konvertueshme nga Shqipëria në Holandë ndërpritet për një periudhë që tejkalon 5 (pesë) ditë;

viii) nëse Atradius tërheq ose anulon ndonjë politikë sigurimi;

ix) nëse kontrata ose kontrata e shërbimit përfundon para kohe nga një vendim arbitrazhi, ose vendim gjykate, ose me marrëveshje ndërmjet palëve të tyre, ose nëse përmbushja e kontratës është ndërprerë për një periudhë të vazhdueshme që tejkalon gjashtë muaj; ose

x) nëse ndonjë ndryshim në ndonjë marrëveshje, ligj, dekret, rregullore, komunikatë, urdhëresë ose politikë, qoftë i lidhur apo jo me transferimin monetar të Huamarrësit, do të ndodhë që nënkupton të sigurojë ose do të ketë efektin e sigurimit të ndonjë dispozite materiale të kësaj Marrëveshjeje të pavlefshme ose të pazbatueshme, ose që nënkupton për të parandaluar ose vonuar materialisht përmbushjen ose zbatimin nga Huamarrësi të detyrimeve të tij materiale si më poshtë (duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në transferimin monetar në Holandë, në monedhë lehtësisht të transferueshme dhe të konvertueshme).

Atëherë, në një rast të tillë dhe në çdo kohë të mëpasshme, nëse kjo ndodhi vazhdon, Huadhënësi, me anë të një njoftimi drejtuar Huamarrësit, mundet ose (a) të deklarojë pjesën e patërhequr të zotimit financiar që duhet anuluar, pas së cilës zotimi financiar do të anulohet menjëherë dhe/ose (b) deklarojë bilancin e huasë më pas të papagueshme së bashku me interesin e shtuar mbi të dhe çdo tarifë dhe çdo shumë tjetër të pagueshme (duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në kostot e zvogëluara) nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje, që duhet të bëhen menjëherë të detyrueshme dhe të pagueshme.

12.2 Pa cenuar klauzolën 12.1 të saj, Huamarrësi do të dëmshpërblejë Huadhënësin kundrejt çdo humbjeje ose shpenzimi që Huadhënësi mund të pësojë, si rrjedhojë e ndonjë pamundësie pagese ose vonese nga Huamarrësi në pagimin e huasë ose interesi i shtuar mbi të apo ndonjë shume tjetër të pagueshme nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje, për sa kohë që kjo humbje ose ky shpenzim, sipas rastit, provohet nga një dokument që specifikon në detaje të arsyeshme shumën e kërkuar.

13. Transferimi

13.1 Huamarrësi nuk do të transferojë ndonjë prej të drejtave dhe/ose detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

13.2 Huadhënësi, mundet në çdo kohë të transferojë të gjitha ose ndonjë pjesë të të drejtave dhe përfitimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, duke transferuar në një ose më shumë banka, Atradius ose institucione të tjera financiare (secila prej të cilave, e quajtur këtu e tutje në këtë klauzolë 13.2 “Bankë marrëse”) të gjitha ose ndonjë pjesë të të drejtave dhe përfitimeve të Huadhënësit, të treguara më poshtë, me kusht që ky transferim të mund të bëhet, nëse Banka marrëse ndërmerr një angazhim ose marrëveshje ndaj Huadhënësit, ku Banka marrëse respekton kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

13.3 Një Huadhënës mund t’i kalojë ndonjë marrësi të mundshëm, sipas klauzolës 13.2, një informacion apo të gjitha informacionet e marra nga dhe/ose në lidhje me Huamarrësin.

14. Tarifat, shpenzimet

14.1 Huadhënësi do të aplikojë për policat e sigurimit, për qëllim të kësaj Marrëveshje të Atradius-it. Premiumet e sigurimit që duhet ti paguhen Atradiusit në lidhje me policat e sigurimit të lartpërmendura, do të paguhen nga Kontraktuesi dhe Konsulenti. Huadhënësi do të informojë

Huamarrësin në lidhje me pagimin e premiumeve të sigurimit.

14.2 Tarifa e menaxhimit prej 0.90% të shumës së shërbimit të kredisë së eksportit që kërkohet paradhënie dhe tarifa e zotimit financiar prej 0.40%, e llogaritur në bazën e ditëve aktuale të kaluara dhe një vit prej 360 ditësh, mbi shumën e patërhequr të zotimit financiar dhe e pagueshme në pagesa të prapambetura gjashtëmujore, për herë të parë gjashtë muaj pas datës së saj dhe për herë të fundit në ditën e fundit të periudhës së vlefshmërisë, do të paguhet nga Kontraktuesi dhe Konsulenti. Huadhënësi do të informojë Huamarrësin në lidhje me pagesën e tarifës së menaxhimit dhe tarifën e zotimit financiar.

14.3 Huamarrësi, nëpërmjet Importuesit, do të rimbursojë Huadhënësin mbi kërkesën e bërë nga Huadhënësi, për të gjitha shpenzimet dhe ndonjë taksë të Shqipërisë mbi të, të shkaktuara në mënyrë të arsyeshme nga Huadhënësi (duke përfshirë shpenzimet ligjore, të udhëtimit dhe harxhimet), duke iu nënshtruar një shume tavan prej 18 000 eurosh dhe të gjitha shpenzimet për mbrojtjen e ndonjë prej të drejtave të tij ose në padinë apo kompensimin e ndonjë shume të pagueshme për Huadhënësin, sipas kësaj Marrëveshjeje.

14.4 Pa cenuar dispozitat në klauzolën 9, Huamarrësi do t'i paguajë në mënyrë të drejtpërdrejtë autoriteteve përkatëse tatimore të gjitha taksat dhe tatimet dokumentuese të pullave dhe taksave apo tatimeve të tjera, ndaj të cilave kjo Marrëveshje ose ndonjë dokument tjetër i përdorur në lidhje me të apo marrja hua e parave të shqyrtuara më poshtë, mund t'i nënshtrohen ose ndodhin në Shqipëri, dhe do t'i paguajë Huadhënësit të gjitha këto shuma, sipas nevojës, për të dëmshpërblyer Huadhënësin përkundrejt ndonjë përgjegjësie ose të gjitha përgjegjësive në lidhje me ose që rrjedhin nga ndonjë vonesë apo pjesë të lënë nga ana e Huamarrësit për pagimin e këtyre taksave dhe tatimeve.

14.5 Siç përdoret në këtë klauzolë 14, termi "taksë" ose "taksa" përfshin të gjitha taksat, tatimet, shërbimet, tarifat, zbritjet, detyrimet ose taksat e tashme dhe të ardhshme të pullës ose regjistrimit dhe çdo kufizim dhe kushtet që rezultojnë në një tarifë.

15. Kostot e rritura

Në rast të një ndryshimi në rregulloret e ndryshme të zbatueshme ndaj ndonjë Huadhënësi nga ndonjë autoritet, veçanërisht në lidhje me rezervimin e kërkesave ose ndonjë taksë apo zbritje (me përjashtim të taksës së të ardhurave të vendosur mbi të ardhurat totale të Huadhënësit), ose në rast të paraqitjes nga ndonjë autoritet të rregullave dhe rregulloreve të reja, si dhe ndryshimeve në interpretimin e këtyre rregullave dhe rregulloreve me efekt të krahasueshëm, kur ky ndryshim në të vërtetë cenon kompensimin neto të përftuar nga Huadhënësi në lidhje me këtë Marrëveshje, Huadhënësi do të njoftojë Huamarrësin dhe asnjë tërheqje sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të lejohet më tej nga Huadhënësi. Nëse është e zbatueshme për Huadhënësin, pa cenuar të drejtat ose statusin e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, në këtë rast Huamarrësi dhe Huadhënësi do të konsultohen me njëri tjetrin, me qëllim arritjen e një zgjidhjeje reciprokisht të pranueshme. Nëse sa më sipër nuk është e praktikueshme, ose nëse Palët nuk arrijnë një marrëveshje brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune pas njoftimit të dhënë Huamarrësit nga Huadhënësi, Huamarrësi mund të përzgjedhë, ose a) t'i paguajë Huadhënësit këto shuma siç Huadhënësi mund të vërtetojë rregullisht si kompensim për këto kosto të rritura; ose b) të shlyejë huanë në përpjesëtim të drejtë me zotimin financiar të këtij Huadhënësi, plus të gjithë interesin, tarifat dhe kostot e pagueshme sipas klauzolës 14 deri në datën e parapagimit.

16. Llogaritë

Huadhënësi do të mbajë në përputhje me praktikën e tij të zakonshme, një llogari ose llogari që tregojnë shumën totale të të gjitha shumave të parapaguara herë pas here nga Huadhënësi dhe herë pas here raportuar Huamarrësit nga Huadhënësi, interesin e shtuar mbi të (të dyja sipas klauzolës 5 ose sipas klauzolës 11.3) herë pas here dhe të gjitha pagesat dhe tërheqjet në lidhje me to, të bëra herë pas here sipas kësaj Marrëveshjeje. Llogaria ose llogaritë e mbajtura nga Huadhënësi, në mungesë të moskorrektesës flagrante, do të përbëjnë fakte *prima facie* të huasë, ndonjë shtesë të interesit, tarifave, kostove dhe shpenzimeve.

17. Pavarësia e marrëveshjes së huasë

Huadhënësi nuk do të jetë përgjegjës për përmbushjen e kontratës ose kontratës së shërbimit dhe nuk do të ketë asnjë detyrim për të ndërhyrë në ndonjë mosmarrëveshje që lind nga përmbushja e saj. Çdo pretendim që Huamarrësi ose Importuesi mund të kenë kundër Kontraktuesit ose Konsulentit, ose ndonjë pale tjetër (dhe/ose pasardhësve ose marrësve të tyre) nuk do të cenojë detyrimin e Huamarrësit për të bërë pagesa sipas kësaj Marrëveshjeje dhe nuk do të përdoret si mbrojtje ose kompensim, kundërkërkesë ose kundërapel për detyrimin e tij për të bërë këto pagesa.

18. Vazhdimi i të drejtave

Asnjë pamundësi për të ushtruar dhe asnjë vonesë në ushtrimin, nga ana e Huadhënësit, të ndonjë të drejte, kompetence ose privilegji të treguar më poshtë, nuk do të funksionojë si heqje dorë nga kjo, as ndonjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte, kompetence ose privilegji, nuk do të përjashtojë ndonjë tjetër nga ushtrimi i mëtejshëm i tyre ose ushtrimi i ndonjë të drejte, kompetence apo privilegji tjetër. Të drejtat dhe zgjidhjet ligjore të parashikuara në këtë Marrëveshje janë kumulative dhe joekskluzive për ndonjë të drejtë ose zgjidhje ligjore të parashikuar me ligj.

19. Njoftimet

Të gjitha njoftimet, këshillat, deklarimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera (të gjitha prej të cilave të quajtura këtu e tutje në këtë klauzolë "Njoftimi"), do të bëhen në gjuhën anglisht dhe mund të bëhen me shkrim me faks ose me letër:

Në rastin e Huamarrësit në adresën:
Ministria e Financave
Dr S.Shehu. Zëvendësministër
Znj. M.Treska, Drejtoria e Borxhit
Blvd "Dëshmorët e Kombit", nr.4
Telefon: +355 4 228373
Faks: +355 4 258435
Email: shshehu@minfin.gov.al
Email: mtreska@minfin.gov.al

Dhe në rastin e Huadhënësit në adresën:
ING Bank N.V.
Structured Finance& Agency Services
Vendndodhja: HE 03.04
P.P.Box 1800/1000 BV Amsterdam, Holandë
Telefon: 31-20-56 34144/34196/35081
Faks: 31-20-56 35239
Në vëmendje të: z.Befort
Email: Frank.Befort@ingbank.com

Ose ndonjë adresë tjetër, siç mund të njoftohet herë pas here me shkrim, nga secila Palë drejtuar Palës tjetër, me kusht që ndonjë ndryshim i tillë të ndodhë që nga dita e tretë pas ditës së marrjes së njoftimit përkatës nga Pala tjetër (për sa kohë që nuk është njoftuar në të një datë e mëvonshme).

19.2 Çdo njoftim i tillë do të çmohet të jetë dhënë rregullisht ditën e tretë pas postimit, (nëse dërgohet me postë diplomatike) ose menjëherë pas transmetimit, (nëse dërgohet me faks).

19.3 Pamundësia e Huadhënësit për të paraqitur ndonjë njoftim ose pamundësia për ta bërë këtë nuk do të konsiderohet si çlirim i Huamarrësit nga ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

20. Të ndryshme

Nëse:

i) paraqitja ose ndonjë ndryshim në (ose në interpretimin, administrimin apo zbatimin) e ndonjë ligji ose rregulloreje të bërë pas datës së kësaj Marrëveshjeje;

ii) ndonjë ndryshim në statusin e [Huamarrësit ose Importuesit] pas datës së kësaj Marrëveshjeje; ose

iii) një transferim i propozuar ose transferim nga Huadhënësi të ndonjë prej të drejtave dhe detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje ndaj një pale që nuk është Huadhënëse para këtij transferimi.

Detyron Huadhënësin (ose në rastin e paragrafit (iii) më sipër, ndonjë Huadhënës të ri të mundshëm) të jetë në pajtim me procedurën "njih klientin tënd" ose procedura të ngjashme identifikimi në rrethanat kur informacioni i nevojshëm nuk është në dispozicion të tij, Huamarrësi ose

Importuesi , menjëherë sipas kërkesës së Huadhënësit, do të japë ose sigurojë dhënien e këtij dokumentacioni dhe prove tjetër, siç kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Huadhënësi (për vete ose në rastin e ndodhisë së përshkruar në paragrafin (iii) më sipër, në emër të ndonjë Huadhënësi të ri të mundshëm) për të përmbushur dhe për të qenë i bindur se ai ka respektuar të gjitha kontrollet nën parimin "njih klientin tënd" ose kontrolle të tjera të ngjashme, sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme në bazë të transaksioneve të shqyrtuara në Marrëveshje.

21. Ligji dhe juridiksioni

21.1 Kjo Marrëveshje dhe përmbushja e saj do të rregullohen dhe interpretohen në përputhje me legjislacionin e Holandës.

21.2 Në këtë mënyrë, Huamarrësi dhe Huadhënësi i drejtohen në formë të parevokueshme juridiksionit të gjykatave të Amsterdamit, Holandë. Në rastin e veprimit ligjor ose procedimeve brenda juridiksionit të Gjykatës së Holandës, Huamarrësi përzgjedh si vendbanimin e tij:

Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Holandë.

21.3 Në shkallën që Huamarrësi në ndonjë juridiksion, mund të pretendojë për vete ose asetet apo të ardhurat e tij imunitet nga padia, ekzekutimi, konfiskimi (qoftë në ndihmën e ekzekutimit, para vendimit ose në mënyrë tjetër) ose procesi tjetër ligjor dhe në shkallën që në këtë juridiksion mund të atribuohet në të ose asetet apo të ardhurat e tij, ky imunitet (i pretenduar apo jo), Huamarrësi bie dakord të mos pretendojë dhe të heqë dorë në mënyrë të parevokueshme nga ky imunitet.

Në dëshmi sa më sipër, palët e kësaj Marrëveshjeje kanë bërë që kjo Marrëveshje të ekzekutohet rregullisht në dy kopje autentike në ditën dhe vitin e shkruar fillimisht më sipër.

Huamarrësi:

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, që vepron nga dhe nëpërmjet Ministrisë së tij të Financave

Nga:

(nënshkrimi/nënshkrimet e autorizuara)

Huadhënësi:

ING Bank N.V

Nga:	Nga:
Emri:	Emri:
Titulli:	Titulli:

BASHKËLIDHJA A

FORMULARI I OPINIONIT LIGJOR MBI HUAMARRËSIN QË DUHET TË JEPET NGA MINISTRIA E DREJTËSISË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Drejtuar: ING Bank N.V si Huadhënësi

Lënda: Marrëveshja e Huasë "Marrëveshja" ndërmjet (1) Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron nëpërmjet Ministrisë së tij të Financave, si huamarrësi "Huamarrësi", (2) ING Bank N.V si Huadhënësi e datës [ ] për një shumë deri në 12 447 524 Euro.

Të nderuar Zotërinj,

Unë kam shqyrtuar:

a) marrëveshjen (që përfshin provat materiale);

b) vërtetimin e barrës "Vërtetimi"; dhe

c) dokumente, vërtetime, dokumente Qeveritare të tjera dhe instrument të tjerë (duke përfshirë ato të referuara në vërtetimin e bashkëlidhur në të), pasi i kam çmuar të nevojshme për përgatitjen e opinionit të shprehur më poshtë.

Ky opinion jepet me qëllim plotësimin e kërkesës së parashtruar në klauzolën 3.1 (i) të Marrëveshjes. Termat e përkufizuara në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim kur përdoren në këtë opinion.

Unë jam i mendimit se:

i) Huamarrësi ka kompetencën dhe autoritetin e plotë ligjor për të ekzekutuar dhe dorëzuar Marrëveshjen, për të marrë hua, huanë siç parashikohet këtu dhe për të përmbushur dhe zbatuar dispozitat e saj që duhen përmbushur dhe zbatuar dhe se të gjitha veprimet legjislative, administrative dhe veprime të tjera qeveritare që kërkohen për të autorizuar transaksionet e shqyrtuara për këtë arsye dhe ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja e Marrëveshjes nga Huamarrësi, janë bërë rregullisht dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë;

ii) ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja e Marrëveshjes dhe transaksionet e shqyrtuara për këtë arsye nga Huamarrësi: a) nuk shkelin dhe nuk do të shkelin ndonjë dispozitë të Kushtetutës së Shqipërisë ose ndonjë marrëveshje të zbatueshme në të cilën Shqipëria është palë ose ndonjë ligj, dekret, rregullore, komunikatë, urdhëresë ose akt tjetër të ngjashëm të Shqipërisë, ndonjë vendim ose vendim të ndonjë gjykate apo gjykate tjetër ose autoriteti rregullator apo ndonjë vendim arbitrazhi të zbatueshëm të Shqipërisë ose në Shqipëri; ose b) nuk shkelin ndonjë marrëveshje ekzistuese ose instrument tjetër në të cilin Huamarrësi është palë apo që është detyrues për Huamarrësin;

iii) të gjitha miratimet, licencat, aprovimet ose autorizimet, apo regjistrimi, dokumentet ose arkivimi pranë ndonjë autoriteti, strukture ndihmëse ose nëpunësi të Shqipërisë apo në Shqipëri, që kërkohet për ekzekutimin, dorëzimin ose përmbushjen e Marrëveshjes nga Huamarrësi ose për vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e saj, janë në fuqi dhe efekt të plotë;

iv) Marrëveshja përbën detyrime të ligjshme, të vlefshme dhe vendimtare të Huamarrësit, të zbatueshme kundrejt Huamarrësit në përputhje me kushtet e tij dhe borxhi i Huamarrësit sipas Marrëveshjes është dhe do të jetë në të gjitha kohët borxhi i tij i përgjithshëm, i drejtpërdrejtë dhe i pakushtëzuar;

v) personi (personat) që ekzekutojnë Marrëveshjen është/janë tërësisht të autorizuar për ta ekzekutuar atë, për dhe në emër të Huamarrësit;

vi) secili prej nëpunësve të Huamarrësit, i treguar në vërtetimin e lëshuar në emër të Huamarrësit, në përputhje me klauzolën 3.1 (iii), ka të drejtën, kompetencën dhe autoritetin për të nënshkruar në emër të Huamarrësit të gjitha njoftimet, komunikimet dhe vërtetimet që duhen dhënë ose lëshuar nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes;

vii) Huamarrësi i nënshtrohet ligjit civil dhe tregtar në lidhje me detyrimet e tij sipas Marrëveshjes. Ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja e Marrëveshjes nga Huamarrësi dhe transaksionet e shqyrtuara për këtë arsye, përbëjnë veprime private dhe tregtare, sesa akte qeveritare ose publike. As Huamarrësi, as ndonjë prej aseteve të tij, sipas ligjit të Shqipërisë, nuk ka të drejtë imuniteti nga juridiksioni i ndonjë gjykate, padi, ekzekutim pas një vendimi, konfiskim para vendimit ose në ndihmë të ekzekutimit pas një vendimi, kompensim ose ndonjë proces tjetër ligjor (qoftë nëpërmjet paraqitjes së procesit ose njoftimit apo në mënyrë tjetër), në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes;

viii) paraqitja e parevokueshme e Huamarrësit në juridiksionin e gjykatave të Amsterdamit dhe marrëveshja e Huamarrësit se Marrëveshja do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Holandës, janë të ligjshme, të vlefshme dhe detyruese dhe do të njiheshin dhe zbatoheshin nga gjykatat e Shqipërisë, në rast të ndonjë procedimi në lidhje me Marrëveshjen në Shqipëri;

ix) asnjë ndodhi mosplotësimi pagese nuk ka ndodhur, as ndonjë ndodhi nuk ka ndodhur që me dhënien e njoftimit dhe/ose kalimin e kohës do të përbënte ndodhi mosplotësimi pagese;

x) asnjë çështje gjyqësore ose procedim administrativ nuk është e pazgjidhur ose, sipas dijenisë së Huamarrësit, nuk është kërcënuar me shkrim kundër atij ose ndonjë prej aseteve të tij, që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të cenojë seriozisht mundësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij financiare sipas Marrëveshjes ose që vë në dyshim ligjshmërinë, vlefshmërinë ose efektin detyrues të ndonjë dispozite të Marrëveshjes;

xi) sipas ligjit të Shqipërisë në fuqi në datën e Marrëveshjes, për të siguruar zbatueshmërinë ose pranueshmërinë në dëshmi të Marrëveshjes në Shqipëri, nuk është e nevojshme që Marrëveshja ose ndonjë dokument tjetër i shqyrtuar për këtë arsye, të arkivohet ose regjistrohet, ose të paguhet ndonjë taksë ose tarifë në Shqipëri;

xii) që në datën e Marrëveshjes, asnjë pullë ose taksë apo tarifë tjetër në lidhje me përgatitjen, ekzekutimin, dorëzimin, arkivimin, regjistrimin, përmbushjen ose zbatimin nga Huamarrësi dhe/ose Huadhënësi të Marrëveshjes, nuk kërkohet në Shqipëri ose ndonjë autoritet tatimor ose fiskal në lidhje

me këtë ose në të;

xiii) ndërsa në datën e Marrëveshjes nuk ka taksa mbi të ardhurat ose taksa të tjera në Shqipëri ose në ndonjë autoritet tatimor ose fiskal në lidhje me këtë ose në të, të vendosura nga zbritja ose në mënyrë tjetër, që vendosen mbi çdo pagesë që duhet të bëhet nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes ose vendosen mbi ose në bazë të ekzekutimit ose dorëzimit të Marrëveshjes nga Huamarrësi ose ndonjë dokument tjetër që duhet të ekzekutohet dhe dorëzohet sipas Marrëveshjes nga Huamarrësi;

xiv) detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes klasifikohen të paktën *pari passu* në prioritet të pagesës me të gjitha borxhet e tjera të pakushtëzuara dhe të dorëzuara të Huamarrësit;

xv) nuk ka dhe nuk do të ketë si rezultat i ekzekutimit, dorëzimit ose përmbushjes së Marrëveshjes ndonjë barrë mbi të gjitha ose një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave ose aseteve të tashme ose të ardhshme të Huamarrësit;

xvi) përzgjedhja nga Huamarrësi e një vendbanimi në Holandë për qëllim të Marrëveshjes në përputhje me klauzolën 21.2 të saj, është autorizuar, ekzekutuar dhe dorëzuar rregullisht dhe detyrimi i Huamarrësit për të përzgjedhur një vendbanim në Holandë për qëllim të Marrëveshjes, është i ligjshëm, i vlefshëm dhe detyrues;

xvii) Huamarrësi nuk është në mosplotësim pagese sipas ndonjë akti, marrëveshjeje ose kontrate në të cilën ai është palë ose që është detyruese mbi Huamarrësin ose ndonjë prej aseteve të tij, mosplotësimi i pagesës së të cilave do të kishte pasojë të rëndë materiale mbi Huamarrësin ose do të cenonte seriozisht mundësinë e tij për të përmbushur dhe zbatuar në mënyrën e duhur detyrimet e tij sipas Marrëveshjes;

xviii) nuk është e nevojshme ose e rekomandueshme sipas ligjeve të Shqipërisë: a), me qëllim që t'i mundësojë Huadhënësit zbatimin e të drejtave të tij sipas Marrëveshjes; ose b) për shkak vetëm të ekzekutimit të Marrëveshjes; ose c) përmbushjes nga Huadhënësi të detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes, që ai duhet të jetë i licencuar, i kualifikuar ose i autorizuar në ndonjë formë tjetër për të vazhduar biznesin në Shqipëri;

xix) Huadhënësi nuk çmohet dhe as nuk do të çmohet të jetë rezident, me vendbanim, që vazhdon biznesin ose që i nënshtrohet apo mban përgjegjësi për taksa, tatime, tarifa, zbritje brenda Shqipërisë, për shkak vetëm të negocimit, përgatitjes, ekzekutimit, përmbushjes, zbatimit dhe/ose marrjes së ndonjë pagese sipas Marrëveshjes; dhe

xx) ligji shqiptar do të njohë dhe pranojë zëvendësimin sipas ligjit holandez të Atradius në të drejtat e Huadhënësit sipas Marrëveshjes, pas çdo pagese nga Atradius sipas ndonjë police sigurimi Atradius.

Nuk shpreh asnjë mendim për çështjet e rregulluara nga ndonjë ligj i ndryshëm nga ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Me respekt
[emri i printuar dhe nënshkrimi]

BASHKËLIDHJA B

DRAFTLETËR NGA AMBASADORI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Drejtuar: ING Bank N.V si Huadhënësi

Lënda: Marrëveshje huaje "Marrëveshja" ndërmjet (1) Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron nëpërmjet Ministrisë së TIJ të Financave, si huamarrësi "Huamarrësi", (2) ING Bank N.V si Huadhënësi, të datës [ ] për një shumë deri në 12 447 524 euro.

Të nderuar Zotërinj,

Në vijim të faktit që Huamarrësi ka zgjedhur si vendbanim të tij ambasadën e Republikës së

Shqipërisë në Holandë, për qëllim të ndonjë veprimi ose procedimi ligjor brenda juridiksionit të Gjykatës së Holandës, siç referohet dhe në përputhje me klauzolën 3.1 (xvi) dhe klauzolën 21.2 të Marrëveshjes, unë bie dakord në mënyrë të parevokueshme për të vepruar si agjent i Huamarrësit për paraqitjen e procesit në Holandë dhe për të pranuar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit secilën dhe të gjitha deklaratat ligjore dhe deklarata të tjera, urdhra gjyqësorë, fletëthirrje për në gjyq dhe dokumente të tjera, sipas nevojës ose që çmohen të përshtatshme në lidhje me përmbushjen e duhur të këtij funksioni.

Me respekt
[emri i printuar dhe nënshkrimi]
[adresa]
Ambasadori i Republikës së Shqipërisë

BASHKËLIDHJA C

PROGRAMI I TËRHEQJEVE, TRANSHI A

(tregues/të gjitha shumat në euro)

Nr.	%	Sasia	Nga granti A		Nga transhi A	Raporti
Parapagim	15	3 655 650	2 437 100		1 218 550	66.66% / 33.33%
Kosto financimi		1 899 892	1 424 919		474 973	75% / 25%
Pagesa avancimi		17 253 908	7 255 931		9 997 977	42.05% / 47.95%
Shpenzime të papritura		343 000	343 000		0	100% / 0%
Pagesa përfundimtare		1 218 550	1 218 550		0	100% / 0%
		24 371 000	12 679 500		11 691 500	

Raporti ndërmjet një tërheqjeje nga transhi A dhe një pagese nga granti A do të jetë siç përcaktohet në programin e tërheqjeve. Numri i tërheqjeve mund të jetë deri në 50, ku raporti ndërmjet një tërheqjeje nga transhi A dhe një pagese nga granti A do të jetë gjithmonë sipas programit të tërheqjes.

PROGRAMI I TËRHEQJEVE, TRANSHI B

(tregues/të gjitha shumat në euro)

Nr.	%	Sasia	Nga granti B		Nga transhi B	Raporti
Parapagimi	15	279 750	186 500		93 250	
Kosto financimi		140 000	105 000		35 000	75%/25%
Pagesa progresi		700 640	260 706		439 934	37.21%/ 62.79%

Shpenzime të papritura		100 000	50 000		50 000	50% /50%
Pagesa përfundimtare		93 250	93 250		0	100%/0%
Asistencë teknike		551 360	413 520		137 840	75%/25%

Raporti ndërmjet një tërheqjeje nga transhi B dhe një pagese nga granti B do të jetë siç përcaktohet në programin e tërheqjeve. Numri i tërheqjeve mund të jetë deri në 24, ku raporti ndërmjet një tërheqjeje nga transhi B dhe një pagese nga granti B do të jetë gjithmonë sipas programit të tërheqjes.

BASHKËLIDHJA D

VËRTETIMI I DETYRIMIT DHE AUTORITETI

Nga:
Drejtuar: ING Bank N.V
[ ]
Amsterdam
Holandë
Si Huadhënësi,

duke iu referuar Marrëveshjes së huasë "Marrëveshja" ndërmjet (1) Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron nëpërmjet Ministrisë së tij të Financave, si huamarrësi "Huamarrësi", (2) ING Bank N.V si Huadhënësi të datës [ ] për një shumë deri në ___ euro, unë, i nënshkruari (personi i autorizuar), vërtetoj me anë të kësaj se më poshtë jepen emrat, zyrat dhe modelet origjinale të nënshkrimeve të personave, secili prej të cilëve do të vazhdojë të jetë (derisa ju të merrni njoftim të autorizuar me shkrim nga ne se ata ose ndonjë prej tyre nuk vazhdon më të jetë) i autorizuar për të ndërmarrë ndonjë veprim që lejohet të ndërmerret, bëhet, nënshkruhet ose ekzekutohet sipas Marrëveshjes.

Emri	Zyra	Modeli i nënshkrimit
.....	.....	.....
.....	.....	.....
.....	.....	.....

Me respekt
.....

Nga:	Nga:
Emri:	Emri:
Titulli:	Titulli:

BASHKËLIDHJA E

FORMULARI I NJOFTIMIT TË ZVOGËLIMIT TË SHUMËS, TRANSHI A

Datë:
ING Bank N.V,
Structured Finance & Agency Services
P.P.Box 1800/1000 BV Amsterdam- Holandë
Telefon: 31-20-56 51052/34196/35081
Teleks: 11402 ING nl
Faks: 31-20-56 51027
Në vëmendje të: z.Befort
Vendndodhja: HE 03.04

Lënda: Marrëveshja e huasë e datës [ ]
Njoftim i zvogëlimit të shumës
Kërkesa nr:.....
Shuma e zvogëluar: euro.....

duke iu referuar Marrëveshjes së huasë "Marrëveshja" ndërmjet (1) Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron nëpërmjet Ministrisë së tij të Financave, si huamarrësi "Huamarrësi", (2) ING Bank N.V. si Huadhënësi, të datës [ ] për një shumë deri në euro

Huamarrësi iu kërkon në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar të bëni një tërheqje sipas transhit A më..... ....., 200..., në shumën prej .....euro, në përputhje me bashkëlidhjen C të Marrëveshjes.

Bashkëlidhur:

- vërtetimi i përkohshëm i pagesës;
- kërkesa korresponduese e tërheqjes ndaj ORET.nl, sipas grantit A.

Me anë të kësaj, Huamarrësi garanton që shuma e tërheqjes të përdoret vetëm për të paguar çmimin e kontratës sipas kontratës dhe i vërteton Huadhënësit se në datën e kësaj kërkese:

i) nuk ka ndodhur asnjë ndodhi mosplotësimi pagese dhe asnjë ndodhi që me dhënien e njoftimit ose kalimin e kohës ose të dyjave, do të përbënte ndodhi mosplotësimi pagese;

ii) përfaqësimet dhe garancitë në përmbajtje të Marrëveshjes mbeten origjinale dhe të sakta që nga data e këtij njoftimi; dhe

iii) janë përmbushur të gjitha kushtet e zbatueshme paraprirëse, të përcaktuara në Marrëveshje.

Termat e përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u jepen atyre në shërbimin e kredisë së eksportit.

Për dhe në emër të
Ministrisë së Financave
Nga:.....
Emri:
Titulli: [ ]

BASHKËLIDHJA F

FORMULARI I NJOFTIMIT TË ZVOGËLIMIT TË SHUMËS, TRANSHI B

Datë:
ING Bank N.V,
Structured Finance & Agency Services
P.P.Box 1800/1000 BV Amsterdam- Holandë
Telefon: 31-20-56 51052/34196/35081
Teleks: 11402 ING nl
Faks: 31-20-56 51027
Në vëmendje të: z.Befort
Vendndodhja: HE 03.04
Lënda: Marrëveshja e huasë e datës [ ]
Njoftim i shumës së zvogëluar
Kërkesa nr.....

Shuma e zvogëluar: euro.....

duke iu referuar Marrëveshjes së huasë “Marrëveshja” ndërmjet (1) Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron nëpërmjet Ministrisë së tij të Financave, si huamarrësi “Huamarrësi”, (2) ING Bank N.V. si Huadhënësi, të datës [ ] për një shumë deri në euro.

Huamarrësi iu kërkon në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar të bëni një tërheqje sipas transhit B, më..... ....., 200...,në shumën prej .....euro, në përputhje me bashkëlidhjen C të Marrëveshjes.

Bashkëlidhur:

- fatura;
- kërkesa korresponduese e tërheqjes ndaj ORET.nl, sipas grantit B.

Me anë të kësaj, Huamarrësi garanton se shuma e tërheqjes do të përdoret vetëm për të paguar çmimin e kontratës sipas kontratës dhe i vërteton Huadhënësit këtë që nga data e kësaj kërkese:

i) nuk ka ndodhur asnjë ndodhi mosplotësimi pagese dhe asnjë ndodhi që me dhënien e njoftimit ose kalimin e kohës ose të dyjave, do të përbënte ndodhi mosplotësimi pagese;

ii) përfaqësimet dhe garancitë në përmbajtje të Marrëveshjes mbeten origjinale dhe të sakta që nga data e këtij njoftimi; dhe

iii) janë përmbushur të gjitha kushtet e zbatueshme paraprirëse, të përcaktuara në Marrëveshje.

Termat e përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u jepen atyre në shërbimin e kredisë së eksportit.

Për dhe në emër të
Ministrisë së Financave
Nga: .....
Emri:
Titulli: [ ]